ADEM ZAPLLUZHA

KUR QAJNË PEMËT

Redaktore:
Sabile Keçmezi - Basha

Recensent:
Sabile Keçmezi - Basha

Lektor:
Veli Veliu

Ballina:
Vesel Xhaferi - Çeliku

ADEM ZAPLLUZHA

KUR QAJNË PEMËT

"TREND"
2016

Libër me kod pritjeje për kujtesën historike

Adem Zaplluzha,"**Kur qajnë pemët**"
Sabile Keçmezi-Basha

Nis Peterson, poet danez, duke folur për rëndësinë e poezisë, thotë: "Mëso, se kur mungon fantazia, sundon vrazhdësia, egoizmi, vdekja. Mëso se pa poezinë njeriu nuk do të ishte i aftë për ndjenja të thella si: dashuria, besimi, patriotizmi ose synimi për një botë të përkryer. Është pikërisht fantazia ajo që gris perden para syve tanë dhe i aftëson ndjenjat tona duke na bërë të zotë të depërtojmë në thelbin e botës që na rrethon"[1]. Dhe, shtrohet pyetja Adem Zaplluzha, është poet, shkrimtar, humanist, tregimtar, romancier, dramaturg, apo që të gjitha i ka me bollëk. Duke e njohur njeriun e penës e të shkrimtarisë jo vetëm në Kosovë në veçanti por edhe në të gjitha trojet shqiptare në përgjithësi, nuk hezitova fare që të jem redaktore e recensent e librit të tij me poezi... i 125-të me radhë.
Kam lexuar shumë nga shkrimtari i nderuar Adem Zaplluzha Dhe asnjëherë nuk më ka ndodhur që me mbylljen e librit të mbyllet edhe jehona e vargjeve të tija. Se libri i shkrimtarit ... është një vëllim me poezi vlerash të veçanta, që nuk kontestohet dhe

[11] Nëntori, nr. 6. Tiranë, 1987, f. 153

përmes përmbajtjes së tyre (poezive) ai trajton tema e motive , sa të dhembshme aq edhe të rëndësishme për kohën e momentin të cilën po e jetojmë. Idetë e mesazhet që sjell me anën e poezive janë të qarta dhe të lënë për një kohë të mendosh gjatë për fatin e kombit e të kombeve. Zaplluzha duke qenë i përgatitur në bërjen e poezisë, ai gjithkund në poezi rrok në pasqyrim çështje e probleme të kohës të gërshetuara në varg mbresëlënës dhe , duke hedhur dritë në dukurit që kanë frymëzuar- objektivisht autori vihet në shërbim të idealeve dhe të shpresave të njerëzve, të cilët përmes shiut, zogjve, kullave, ëndrrave, plepave, lumenjve, cerberëve, katallanëve aspirojnë t'i përmbushin dëshirat me qëllim të sfidimit të së keçes, territ-burg, padrejtësive që kanë ndodhur si në të ikur, në të tanishmen po edhe që përgatitën për të ndodhur, në ditën e ardhme.

Andaj, në poezinë e Adem Zaplluzhës përditshmëritë duken të zymta, anemike, të vrenjtura dhe si të tilla qëndrojnë pezull mbi kokat tona, bile mund të themi se kjo kohë e zymtë dalë ngadalë po i gërryen edhe muranat e kujtesës, (poezia Po i gërryen muranat e kujtesës). Autori i vargjeve i nxënë ngushtë, në një poezi tjetër, pikërisht nga kjo monotoni e ditës, inferioritetit të imponuar dhe romuze gjithë faresh, vetëm sa nuk do të bërtas Këtu edhe netët lehin, poezi me të njëjtin titull.

Porosia e ciklit të parë, ani se në mes rreshtash, na vjen shumë e qartë edhe kur (siç shohim edhe tek poezitë tjera , si: Përngjajnë me njerëzit sy uritur; Nga një mallkim i keq; Mes rrënjëve fshihen të reshurat etj. Nga shumë përgjigje të munguara, mbesim pa fjalë, memecë në kohë, e cila parakalon para syve tanë ku, mungojnë reagimet e pritura edhe kur e dimë se historia e jonë fletë me gjuhën e fakteve.

Këtu edhe netët lehin

cikli i parë

NËN TINGUJT E NJË MUZIKE PAGANE

Sa shumë po i përngjan ky shi njeriut
Po dënes si era
Ky mallkim lotësh
Po bie tok me brymën e verdhë
Po bien edhe perënditë
Si dardhat e kalbura po shkunden yjet

Një natë e shurdhtë
Nga parzma e së cilës pikon trishtimi
Po dënes si shirat e qytetit tim
Po dënesin edhe plepat
Nën tingujt e një muzike pagane
Po lahen zogjtë e mjerimit

Ky shi i bezdisshëm
Po bie pareshtur po bie
Mbi flokët e mjegullave

Sterra e sëmurë
Me qindra vite pret agullimën
Pret zogun e bardhë
Në kepin e shpresës së mirë

NGA ZËRI BARITON I MURANAVE

Ky shi imcak
Sonte po shpërfaqet në qindra trajta
Një çast duket i lëngtë
Kurse çastin tjetër ngjan me gurtë e stralltë

Herë qanë si foshnja
E herë dënes si burri i pikëlluar
Nëpër ullukët e çative
I fsheh të palarat e ditëve të shkuara

Ulet mbi një kërcu të kalbur
Dhe i shpalos mendimet e fshehura
Një dardhë e vjetër shtrinë duart
Me gishtat skelet i prek qerpikët e erës

Shiu në qytetin tim as të dielave s'pushon
Çdo mëngjes e ujit kambanën
Nga zëri bariton i muranave
Shpërthen thirrma e lashtë e një legjende

Prishtinë, 2 dhjetor 2014

PO I GËRRYEN MURANAT E KUJTESËS

Asgjë nuk do të prekim sonte
Nga thonjtë e prerë të erës
Si shirat
Derdhen lumenjtë e çmendur të gjakut
Një nga një
Si gjethet këputen ditët

Çfarë të bëj me duart e mia
Ku t'i fsheh ëndrrat
Kjo stinë e gjatë e dhembjeve
Shekuj me radhë
Po i gërryen muranat e kujtesës

Nuk kam më kohë të ëndërrojë
Po më largohen edhe vegimet
Një zjarr që digjej me vite
Ka filluar të shuhet
Saqë po i përngjanë hirit në hinore

Ky zog krenar që me shekuj fluturoi
Mbi dhembjen e maleve
Sonte bisedon me drurët
Ku asnjëherë qukapikët
Nuk trokasin
Në portat e hapura të gjetheve

NJË DRU I LODHUR

Pak shpresë kemi sot
Nga të dhënat sinoptike
Në çdo çast koha po pëson
Ndryshime marramendëse

I preki gjethet e këputura
Nga degët e pemëve
Shkunden shirat e fshehur
Shkunden me tërë dhembjen e rrënjëve

Një dru i lodhur
Sapo i çeli sytë e lëbyrtë
Shikon se si po bien gjethet e fundit
Po bien si ëndrrat e shthurura

Vegimet i zgjasin duart e brymta
I prekin kallkanët
I prekin me kujdes gjethet e fishkura
Dhe frymëmarrjen e erës së dërmuar

TË NESËRMEN KUR ZGJOHEN PLEPAT

Në Prizren ka vetëm kujtime të lashta
Që ngjajnë me halucinacionet e yjeve
Njerëz me kapela të thella
Nën të cilat fshihen mendimet

Në Prizren ka prizrenasë
Ka edhe njerëz të tjerë që shkarazi
Kalojnë rrugicave të kalldrëmta
Kah kalonin dikur moti gladiatorët

Çfarë s'mund të gjesh në Prizren
Përpos ujit të Lumëbardhit
Që asnjëherë s'kalon dy herë
Shkojnë në përqafim të Jonin krenar

Në Prizren ka edhe dyqane të vjetra
Që i kultivojnë zejet e harruara
Prej kazanxhinjve deri te samarxhinjtë
Ka edhe poçar që bisedojnë me deltinën

Kur ngjallen qepenat në këtë qytet
Këndesat veç bien në gjumë
Të nesërmen kur zgjohen plepat
Nëpër rrugicat e ngushta nuk mejnë serenatat

TE SUKAT E BLERTA

Nëpër degët e pemëve
Si dhembjet çelin lulet e bardha
Çelin edhe disa lloje zogjsh
Që fluturojnë
Netëve të vona nëpër kaltërsitë e pakapshme

Ky det i çmendur i mendjes
Me dallgët e turbullta
Pa mëshirë po i rrah brigjet
Nën shelgjishtet e pikëlluara
Po çelin dhembje zogjtë e korbave

Sivjet të korrurat nuk patën suksese
Një brymë e nakatosur
Që në rrënjë i vrau grunajat
Shumë herët u rrëzuan në tokë
Kallinjtë elbore me egjër

Ne pritëm edhe disa stinë dhe vite
Që të këndellet toka e helmuar
Te sukat e blerta
Ashti i vjetër i malit për çudi
I ngjante drurëve të moçëm gjetherënës

PËRTEJ MENDIMEVE TONA

Kur i krahasojmë duart tona
Me pemët
Secili prej nesh i ngjajmë nga pak
Gjetheve të zverdhura
Dhe degëve të lodhura të stinës

Sytë tanë të ankoruar trishtueshëm
Nëpër pellgje kujtimesh
Duken të mekur
Sa që i shohim të këndellura
Vetëm nëpër fotografit e fëmijërisë

Lagjeve të kalldrëmta i dëgjojmë
Lehjet e harruara monotone
Kur e kthejmë kokën pas
Nuk shohim asnjë fërkem kaprolli
Vetëm brirët e thyer pikojnë një lloj harrese

Më duket se kot i zgjasim duart
Përtej mendimeve tona të mangëta
Shohim vetëm harresën
Dhe pemën e mbjellë në kujtesë
Që kurrë më nuk çeli asnjë lule

KUVENDOJNË ME GJETHET E RËNA

Sonte është tepër vonë
Kurse për nesër
Nuk di a mund të zgjohem
Si format e shiut që bien në vjeshtë

Brigjet shterp
Fërshëllejnë një melodi të harruar
Kurse era fshikullon me kamxhik
Drurin e egër
Që sapo ka çelë do gjethe mëllage

Ulliri i mbjell që nga koha e Skënderbeut
Nga shpirti i tij edhe sot lulëzon
Tërfili me katër gjethe
Lulëzon edhe stina në rrënjët e tokës
Milingonat e verdha
Kuvendojnë me gjethet e rëna

Ky dimër i sivjetmë
Me dhëmb të kallkantë i kafshon degët
Që lakohen deri në tokë
E veriu tinëzar
Bisedon fshehurazi me acarin
Si gjithmonë nata kurdis
Komplotin e saj të mistershëm

NJË ÇERDHE TRISHTILI

Me të dy duart i përqafoj drurët
Rrënjët s'bëzajnë
Nga gjethet i shtrydhi kujtimet
Lulet çelin për herë të dytë
Sytha shpresash të bardha

Një çerdhe trishtili
Mes degëve e paska humbur rrugën
Fëmijët e lagjes
Çmendurisht i kalërojnë kuajt e ëndrrave
Kurse era e jugut po hynë fshehurazi
Në shpirtin e kallkantë të kallamishtes

Sivjet po vonohet pranvera
As dimri nuk ishte këtu pari
Një stinë tjetër asnjanëse
Rrokullisej si e dehur mes gjetheve

Më duket se ne nuk patëm kohë
Ishim të zënë me problemet meteorologjike
Por ama as shiu imcak
Nuk binte atë ditë mbi frikën e ullukëve
Lagjen e kishte mbuluar një etje e madhe

MES RRËNJËVE FSHIHEN TË RESHURAT

Nga gjumi im i pagjumë
Derdhen lumenjtë dhe drurët
Erërat fryn nëpër kujtesën e lisave
Dimrat fshihen mes gjetheve
Kurse njerëzit pas hijeve të tyre

Më duket se nuk kam më kohë
Kaloj nëpër një udhë të parathënieve
Askund asnjë korb nate
Nuk krakëllin më nëpër degë
Mes rrënjëve fshihen të reshurat

Nga gjumi im i pagjumë
Dalin vetëm zogjtë e verbër
I zgjas duart kah veriu
Jugu i çmendur m'i dhunon ndjenjat
Si ta kaloj kështu i vetmuar këtë natë

Ju nuk më kuptuat askurrë
Unë me mund të madh ia vura
Mëgojëzat erës së llastuar
Hingëllonte me dhembje lindja
Kurse perëndimi nuk i ndalte të qeshurat

SA SHUMË DALLOJNË TË URITURIT

Më duket se mollët në mal
E kishin ngjyrën e deltinës
Edhe era e jugut
I përngjante drurëve që flenë gjatë dimrit

Asnjë stinë më
Nuk ka ngjashmëri me vetveten
Sa shumë dallojnë të uriturit
Prej atyre që nuk e njohën kurrë urinë

Në malin tonë të pashpresë
Për herë të parë kuptova gjuhën e drurëve
Sa dhimbshëm qanin gjethet
Kur i shkundte acari i tërbuar

Herët ose vonë
Ne do t'i bashkojmë mendimet tona
E vetmja rrugë që na ka mbetur
Duhet të ja zëmë frymëmarrjen e së keqes

PO TË ISHTE BOTA

Po të ishte bota një zarf i kaltër
Do i shkruaja letër drurëve të malit
Dhe freskisë së gjetheve
E do ja dhuroja erës puthjet e zjarrta

Po të ishte bota një zog krenar
Do fluturoja me të
Nëpër shpirtin kryeneç të furtunës
Do fluturoja deri te ëndrra e një tjetër historie

Po të ishte bota një copë druri
Të murrmë e të karbonizuar
Do i shkruaj letër gjetheve
Dhe çerdheve të zogjve shtegtarë

Po të ishte bota një femër e bukur
Sa shumë njerëz të mirë
Dhe prej atyre të këqij
Do të dashuroheshin në imazhet e saja

Po të ishte bota

ASNJË SHTEG MALI

Kam dalë jashtë mendjes
Dhe hapësirës së murrme
Trokas nëpër dyert e mbyllura
Askush nuk m'i hap dritaret
Por as nuk mi mbyllë portat e fjalëve

Rrugëve të boshatisura
Bredhin makthet e përgjumura
Njerëzit po ikin nga ëndrrat
Asnjë shteg mali
Nuk ka mbetur pa u shkelur në këto çaste

Nëpër zgërbonja drurësh
Si flamujt e leckosur
Kanë mbetur peng fjalët e erës
Pa rënë në tokë si duhet
Fishken gjethet e para vjeshtake

Degët e thyera dhe të vetmuara
Rrahin njëra - tjetrën
Po ashtu edhe rrënjët ndjejnë një shqetësim
Fushave fshikullon acari
Kurse nën çatitë e rrënuara vdesin shpresat

KËTU EDHE NETËT LEHIN

Nëpër qoshet e rrugëve
Si cerberët
Të presin befasitë

Këtu edhe netët lehin
Hëna duket e pikëlluar
Nga flokët e saja pikon misteri

Sipas një rregulli të pashkruar
As nëpër xhade
S'guxon të ecësh vetë i dyti

Netëve pa dëshmitarë
Orët janë fut të zeza
I ngjajnë fateve të njerëzve

Këtu në këtë qytet
Kur shkyçen dritat
Njerëzit mbesin pa emër dhe mbiemër

Prishtinë, 3 dhjetor 2014

KAM NJË HALL E KAM NJË MALL

Kam një hall e kam një mall
Brenda meje digjet një zjarr
Pse s’troket më dashuria
Si dikur të më josh
Asnjë zog s’troket në xham
Mbase më paska lodhur kjo moshë

Kam një hall e kam një mall
Që kur mbeta kështu kërcu
Por akoma në mua digjet një zjarr
Përvëlon eshtra e shkatërron dru
Kam një hall e kam një mall
Që kur mbeta kështu kërcu

PËRNGJAJNË ME NJERËZIT SY URITUR

Zogjtë janë si të varfrit
Askund s'kanë stacion
Ku mund të ndalen
Nuk kanë as pasaporta biometrike

Ndalen aty ku i zë uria
Dhe fluturojnë sërish hapësirave
Po nga ai vend
Ku më par gjetën një kafshatë të mykur

Përngjajnë me njerëzit sy uritur
Fluturimet i ka ë të ngathëta
Por vetëm nëpër degë të thyera
I ndërtojnë ëndrrat

S'lodhen aspak për të gjetur një adresë
Nëpër çdo sukë mali
Ose nëpër shpirtrat e drurëve
Bisedojnë me qukapikët e uritur

Për çudi në shumë stacione trenash
Nuk ngjajnë me njerëzit
S'trokasin askurrë nëpër ato dyer
Që nuk dinë të hapen për të uriturit

SËRISH PËR ZOGJTË

Ju thashë se janë si fëmijët
Me mija ose me qindra mija kilometra
Udhëtojnë pa valixhe
Kur i zë uria
Njeriu s'mund ta sheh vajin në sytë e tyre

Ndoshta edhe nuk qajnë
Në fluturim e sipër harrojnë
Si çfarë sysh ka skamja
Ushqehen me erën
Ose me aromën lëvores së mollëve të pjekura

Në asnjë det nuk lëshojnë
Spirancën e dhembjes
As nëpër ato të autobusëve
S'kanë nevojë për kurrfarë itinerari
Nëpër ëndrra zogjsh
Kurrë s'janë të zbrazëta valixhet

Sa shumë ngjajnë me njerëzit
Që përgjumen nëpër traversat e kalbura
Mëngjeseve herët kur nuk kanë ujë
Sklepat e syve të ënjtur i pastrojnë
Me njomësinë e vesës së mëngjesit

NGA NJË MALLKIM I KEQ

Me mija vjet
Nëpër qiellin e plagosur të Kosovës
Fluturuan zogjtë sqep groteskë
Krakëllimat e erës
Ishin të ngarkuara me dhembje e trishtim

Sa herë që në befasi u takuam
Me sulmet e mushkonjave të verdha
Na u dukën ato çaste si mallkime
Sa që shqyheshin zgërbonjat e lisave
E frynin me tërbim erërat e liga

Në ecejaket tona mbase as nuk pamë
Ditë më të mira se këto
Shtjellohej një flamë e zezë
Nga një mallkim i keq
Çdo gjë e kishte peshën e zezë të kohës

I pamë pranë muranave të shembura
Edhe kryqet e thyera
Që nuk i përngjanin më kryqeve
As kambanat me kambanore
Aspak s'ishin në gjendje më të mirë

Çfarë nuk pamë
Në përqafimin grotesk të trishtimit

DRURËT NGJANIN NJERËZVE PA DUAR

Pesë mijë vjet më parë
Ose pesë mijë pas kësaj kohe
As ditët e shthurura
E as netët
Nuk maten më me dhembje

Para se të lindnim
Na lënë peng një amanet
Ose një mallkim
Që na përcjellë edhe sot
Nëpër këtë golgotë të ekzistencës

I përjetuam thyerjet e urave
Hënën e pamë lakuriqe
Në qindra cifla stërkalash
Dhe sërish
Mbijetuam dhembjen e golgotës

Sa groteske ishin kufomat
Drurët i ngjanin njerëzve
Kërcu pa këmbë e duar
Mendja dhe eshtrat e drobitura
Shkriheshin si kallkanët në pranverë

KUR NA I GRISËN FLAMUJT

Do ecim si në kohërat më të liga
S'do të ndalemi asnjëherë
Jemi nga fisi i meteorëve endacakë
Qiellin e patëm
Dhe e kemi babë e nënë

Fillimi ishte pakëz si një marshim
I pamëshirshëm
Njerëzit brenda vetvetes kërkonin
Atë gur të shenjtë të kohës
Që lëvarej në hapësirë

Çdo gjë dukej
Si një harmoni e koordinuar
Rrjedha e kohës s'kishte të ndalur
Secili njeri matej
Me hijen e vet dhe të diellit

Ngjante që një ditë të jemi të buzëqeshur
Kurse ditën tjetër
Mbi kokat tona të shtypura
Si dhembja ngrysej qielli i varfër
Ngrysej kur na i grisnin flamujt

Nuk ishim fëmijë të lotit
U mësuam t'i durojmë furtunat
Edhe kur çmendeshin
Shpirtrat e lumenjve nga fantazmat
Ne mësuam me kohë
Se si të ecim vertikalisht

Prishtinë, 4 dhjetor 2014

MËNGJESI I DYSHIMTË

Dikur vonë kuptuam
Se si zëri ynë me një shkathtësi
Të padëgjuar e paparë
Fundosej mes gjelbërimit të një oaze

Në lotin e brishtë të devesë
Si gejzer i çmendur
Gufonte një lëng i pa definuar
Shkretëtira rrinte me gojë të hapur

Një mjaullimë e egër
Zbrite nga shkretëtirat e pafundme
Mjaullinte edhe druri i gështenjës së butë
Zëri i kaktuseve i ngjante jehonës së përroit

Mëngjesi i dyshimtë
Herë konvertohej në mbrëmje
E herë në një muzg të mistershëm
Gjethet këndonin një këngë beduinësh

QANIN SI KËRTHINJTË E BRAKTISUR

Nuk di se si vajtëm
Përtej të pamundurës
Nëpër udhët që kaluam
Kudo pamë rrjetë merimange

Një pemë e moçme
Në të cilën kishin mbetur vetëm katër gjethe
Me mund të pashoq i shëronte
Plagët e pashëruara të zgërbonjës

Ditët ishin të gjata pallamarë
Ngjanin me pritjet e trenave të verbër
Paralelet e hekurta
I kishin shkulur pritjet e spirancave

Dielli në lartësi dukej si saç i ndryshkur
I shtri duart deri te mjegullat
Pjergullat në kopshtin e mollëve
Qanin si kërthinjtë e braktisur

Qante edhe era në duet me stinën
Lejlekët veç kishin vajtur në brigjet e diellit
Vetëm korbat dhe krakëllimat e shirave
Dëgjohen te plepat e prera

KJO PRANVERË E VARFËR

Ulur mbi mështeknën e kujtimit
I tjerri ditët e ndrydhura
Nga një copë e vogël druri
Filluan gishtat e këputura si për mahi
T'i ndërrojnë perdet e kohës

Sa me trishtim qante kavalli
Nëpër mendjen time
Era frynte si e çmendur
Një dele e larme i shikonte mjegullat
Se si i përngjanin kullosave të zhveshura

Kudo rreth nesh qanin drurët
Eshka përtypej si kau plak
Më duket se sot është ditë e diel
Rrëshira si mjalti pikon nga stërkalat e shiut
E kambana i përngjan daulleve të kushtrimit

Nga përroi i pikëllimit si jehonë zbrite
Zëri melankolik i shtogut të bardhë
Akaciet nuk kanë çelur sivjet asnjë lule
Kjo pranverë e varfër
Sa shumë po i përngjan fëmijërisë sime

THIRRMAT APOIKALIPTIKE

Hapësirave pamë disa pamje apokaliptike
Nëpër qiellin e plagosur
Si lejlekët në ikje
Fluturojnë zogjtë e verbër

Era i kishte fshehur në flokët e saja
Trishtimet e valixheve
Asnjë udhëtar i vetmuar nate
Mbrëmë s'trokiti në portat e mia

Më duket se kot prita të dëgjoj
Zërin e kambanës
Askush nuk mund t'i kuptoj
Tingujt hyjnore në shpirtin e kambanores

Vetëm një kryq i vetmuar qante
Qante me ngashërim në varret e dëshmorëve
Për pak çaste i humba shqisat e të dëgjuarit
Kur u dëgjuan thirrmat apokaliptike te varret

U TAKOVA ME RRUGËT E PËRGJUMURA

Të gjithë thonë se ishte errësirë
Kurse unë
Përherë e pohoja të kundërtën
Ishte një natë e blertë
Që ngjante me sytë e hënës

Përtej errësirës
Ishte një tjetër dritë inkandeshente
Sa herë që i mbylla sytë e mi të gështenjtë
E shihja tunelin e imagjinatës
Përtej një tjetër drite

Sot herët në mëngjes
Sapo dola nga ëndrra ime
U takova me rrugët e përgjumura
Lumëbardhi përkundej në zhgjëndërr
Kurse ylli i mëngjesit i kalëronte meteorët

Kur qajnë pemët

cikli i dytë

ME NJË VDEKJE TË TRISHTUAR

Njerëzit si zogjtë
Ecin rrugëve të vetmuara
Dhe në fund të çdo tregimi
Pa dashje ballafaqohen
Me një vdekje të shëmtuar

Ditën e parë të javës duken
Se janë të lumtur
Por befasisht
Ngjan e kundërta
Zgjohen me një muzikë të trishtuar

Njerëzit si mushkonjat e verdha
Bredhin shëtitoreve
Nëpër ëndrrat e shthurura
Mbase i kërkojnë
Itineraret e çasteve më delikate

Ngjanë që të përballen me asgjënë
Ecin si të humbur sokakëve
Pa shpresë e dinjitet
Nga xhepat e shqyera nxjerrin pikëllimin
Dhe bëhen pjesë e apostujve të dëshpëruar

Prishtinë,5 dhjetor 2014

TË GJITHA UDHËT

Nga zëri i pa artikuluar i një peme
I dëgjoja thirrmat e erës
Binte një shi i qulltë atë natë
Sa që i nxori rrënjët mbi tokë

Frynte edhe një stuhi e rreptë
Nëpër degët e thyera
Asnjë lule mëllage
S'kishte çelur në mëngjes

Njerëzit vraponin si pa kokë
Secili nëpër trasta të dhirtë
E barte mëkatin e vet të pafalshëm
Dhe atë të gjyshërve si amanet

Ata ecnin rrugës së moskthimit
Të gjitha udhët
Ngjanin në rebuse abstrakte
Ishin të lidhura në një nyje të pashpresë

I HAPIMË SYTË NË DREJTIM TË DRURËVE

Për çdo ditë
Kur zgjohemi nga gjumi
Jemi të trembur
Si zogjtë shtegtarë bredhim rrugëve të gjata

Ngjajmë me patat e hutuara
I hapim sytë në drejtim të drurëve
Dhe shohim zbrazëtirën e ngrirë
Se si zgërdhihet me pasqyrën

Ecim rrugëve të vetmuara
Në sytë bojë hiri të vogëlushëve
I kërkojmë ëndrrat e marionetave
Ose kukullave të djegura të fëmijërisë

Në secilin hap
Deshëm ne ose nuk deshëm
Takohemi me vetveten tonë të humbur
Takohemi mes parathënieve të kashelashave

Nga sytë e lëbyrta të drurëve
I shtrydhim shpirtrat e mjegullave
Mëngjeset na presin të përgjumur
Që në befasi të na i gllabërojnë ëndrrat

Nuk jemi në gjendje të ecim më tej
Ama as të ndalemi
Nën shputat e erës së sfilitur
Dita përjeton aktin e fundit të vetëflijimit

VESHUR ME SEDEF GUACASH

Këto udhë
As këto lagje dikur nuk ekzistonin
Ashtu siç nuk ekzistonim as ne
Ia behën mjeshtrit e të gjitha zejeve
Dhe i ngjyrosën mjegullat
Me ngjyrat më të bukura të ylberit

Thonë se njëherë moti
Një zog shtegtar i lë këtu disa glasa
I lë mbi një çati të braktisur
Dhe fill zuri të çeli lule një pemë
Sa që në sytë e ullukëve i krijoi lotët
Të cilët i ngjajnë shirave të vjeshtës

Siç mësuam prej njerëzve
Këndej pari
Kurrë nuk kishte pasur gjelbërim
Nga gurtë e murrmë mbinte një gur i bardhë
Veshur me sedef guacash
Aq bukur dukej në gjoksin e hënës
Sa që u dashuruan edhe meteorët endacakë

ME VËSHTIRËSI LISAT MERRNIN FRYMË

Në qytetin tim
Kurdoherë stinët ishin dimër
Dielli i kallkantë
Dukej se i përngjante dhembjes
E cila nuk kishte shërim

Dy zogj shikonin mëngjesin
Se si ndrydhej nën ingranazhet e tmerrit
Mbi qiellin e plumbtë
S'pushonin krakëllimat e një golgote
E cila posa filloi të zvarritet

Një kryq prej mishi
Në një tërmale të zorshme
Barte vetveten
E barte edhe emrin e vet që nga lindja
Për të mbase s'kishte perëndim

Me vështirësi lisat merrnin frymë
Frymonin edhe stërkalat e shiut
U dëgjuan edhe gjëmat e grave
Me një krakëllimë të tmerrshëm
Pamë se si u plandos në tokë shpend i bardhë

MBI NJË GUR STRALLI

Akoma s’e kam të qartë
Pamjet e një vegimi
Se si dolën nga korniza e fshehur
Një pëllumb i bardhë sa ora
Fluturoi hapësirave të paanë

Disi si qumështi i deles galane
Grafulloi pranvera
Lulet e kuqe të mëllagës si zambakët
E bardhë filluan të mbinë
Në shpirtin shterp të shkretëtirës

Stepat e egra u shndërruan në oaza
Si devetë filluan të përtypen palmat
Një merimangë e murrme
Mbi një gur stralli
Endte rrjetën e së nesërmes

TE PORTAT E JASHTME

Te portat e jashtme
Nëpër shpirtin e muranave
Përplasen hijet e plagosura
Si e çmendur nga dhembja buluron nata

Sonte nuk u ndalën shirat
Po ashtu edhe krakëllimat e korbave
Verbuan syrin e djathtë të sterrës
Po ikin edhe zogjtë e fëmijërisë
Po largohen zogjtë nga imazhet e trishtuara

Asnjë zë njeriu s'dëgjohet tej muranave
Vetëm kau i moshuar
Bërlyket në grazhdin e harruar
E shiu po bie pandërprerë
Po bie si në kohët e dhembjeve të zeza

Te portat e jashtme sërish trokitën
Të huajt e paftuar
Njëmijë vjet nuk pushuan
Bulurimat e natës së plagosur
E shiu akoma po i lag çatitë e rrënuara

THONË SE QIELLI ISHTE I NGRYSUR

Kishte gra
Shumë gra fëmijë dhe burra
Sa shumë lot buluruan atë çast
Kur rrugëve të golgotës
Ecte një kryq këmbëzbathur

Thonë se qielli ishte i ngrysur
Pas disa mjegullave të zeza
Ndoshta jo nga frika
Por diçka e tmerrshme fshihej
Dielli i ngrysur shikonte tokën

S'pushonin as gjëmat e shiut
Lëkurën e grisur të erës së asaj dite
Spërkasnin stërkalat e ngrira të kallkanëve
Mbi kokat dhe shamitë e grave
Ulërinte një gjëmë e pabesueshme

Si foshnja e sëmurë
Me ngashërim qante qielli
Kurse Ati e shikonte të birin
Dhe pa pikë loti në sy
I përcillte delet në kullosat e përjetësisë

NUK PRAJNË AS MJAULLIMAT

Një ditë do i përngjajmë zogjve
Kurse ditën tjetër
Gurëve të ngulitur në plagët e atdheut
Më besoni shumë pak fjalë kemi sot
Kur i ndjejmë bulurimat e përroit

Mëngjeseve herët
Bie nga pak një brymë e brishtë
Nga të katër anët e botës pështynë era
Nuk prajnë as mjaullimat
Nga një sëmundje e panjohur vdesin netët

Nëpër rrugët e qytetit të zbrazët
Shoh njerëz me kapela dhe pallto të shqyera
Duhma e kontejnerëve me të dy duart
I mbyllë sytë e përlotur të skamjes
Hëna e lodhur dënes si kërthi i braktisur

CILI DJALL HYRI KAQ HAJNISHT

Nuk shërohet dot asnjë plagë
Duke shkelur
Mbi plagët e të tjerëve
Një mallkim i paparë
Si breshëri ka rënë mes njerëzve

As shiu më i rreptë
As breshëri më i pështirë
Nuk mund t'i lëndoj pemët kaq shumë
Si nëpër vegime
Mbrëmë i pashë degët e alivanosura

Cili djall hyri kaq hajnisht
Mes njerëzve
Dhe si përroi i zi
Po gërryen kaq shumë shpirtra
Të drurëve dhe pemëve të njoma

Prishtinë, 6 dhjetor 2014

ATA QË FLENË

Mbrëmë kuptova
Se përtej mendimeve tona
Derdhen lumenjtë e çmendur
Si kaprojtë e egër vrapojnë mëkatet
Vrapojnë si derrat e zi
Të gjitha të ligat në mendjen e njeriut

Me qindra vjet drite udhëtuam nëpër ferr
Posa dolëm në dritë
Hymë në një tjetër ferr më të pështirë
Shkelëm nëpër urat e thyera
Dhe kurrë më
Nuk patëm rast të dalim në dritë

Ndoshta edhe e merituam
Këtë gjendje pa rrugëdalje
Me mija vjet po ecim symbyllur
Ëndrrat i kemi të fjetura
E ata që flenë
Kurrë nuk mund t'i çelin sytë

MË DUKET SE ISHTE KOHA E LULEVE

Kjo hapësirë e kaltër
Pa ty nuk merr frymë
Nuk frymojnë as drurët
Si deveja e moshuar kollitet druri

Oaza s'bëzan
Në heshtej mortore shtrihet shkretëtira
Zhuri i përskuqur pëlcet në diell
Kurse merimanga thurë të nesërmen

Zhapiku i pështynë kaktuset
Nga majat e thikave si loti
Pikon trishtimi
Fundi i një beteje doli në bejleg

Më duket se ishte koha e luleve
Kurse acari i shqyente drurët
Ky mal i çmendur i mendjes
S'po mund t'i ndalë ethet e drurit

MË NË FUND KUPTOJMË

Jeta është një kontejner
Dhe tunel pa dritë
Në secilin hap na ngarkojnë
Dhe vetë ngarkohemi me mëkatet tona

Në çdo kohë dhe mot të lig
I hapim valixhet e zbrazëta
I hapim nga smira
Dhe ia prishim gjumin Pandorës

Me hapa të shthurura
Ngarendim në askund
Për të mbërri në askurrkund
Veç duhet t'i kapërcejmë stinët

Nëpër stacionet e mendjes
I kurdisim orët e ndalura
Dhe gjatë tërë kohës vendnumërojmë
Në monotonin e ulërimës së ujqërve

Kur mbërrimë në stacionin e fundit
Më në fund kuptojmë
Se fundi kurrë nuk ka ekzistuar
Në itinerarin e anijes së përgjumur

TË T'I PËRKUJTOJ GJËMAT E DITËVE

Kur del në rrugë
Merë me vete një copë druri
Dhe ashtin e kësaj toke
Që ka mbetur nga dimri i acartë

Merre me vete edhe ofshamën e lumit
Të t'i përkujtoj gjëmat e ditëve
Kur i përjetove sërish
Përmbytjet e drurëve të njoma

Të lutem mos harro edhe shtambën e gjyshit
Me të cilën dyqind ushtarë të atdheut
E shuan etjen atë ditë
Kur kallej flakë kjo tokë e zhuritur

Poqë se del në rrugë në atë çast të trishtuar
Ja kthen shpinën atdheut
Pyete Atin në qiell dhe në shpirtin tënd
Se çfarë të pret pas atyre maleve të lakmisë

KU NA MBETËN FJALËT

Ku na mbetën fjalët e dhëna
Çfarë ngjau me besimin tonë pagane
Kjo lojë e lashtë e pantomimës
Po i çmend drurët në mal

Mermeri i murrmë ka zënë myk
Myshqet më nuk lëshojnë rrënjë
Pranë muranave të shembura
Po vajton atdheu im i leckosur

Ku na mbetën fjalët e dhëna
Nëpër teatrot e qytetit
Ka kohë që janë lëshuar perdet e trishtimit
Një palë këpucë të verdha lëvaren mbi tela

Ku na mbetën lëvizjet e një pantomime
Athua vallë u shndërruam në statuja
Që heshtin si mermeri i kuq
Ku na mbetën fjalët e dhëna

PERËNDIMI ME DISA ZOGJ TË HEKURT

Nëpër shpirtin e grisur të detit
Llamburitin anije me vela të bardha
Flamujt e dhembjeve
Si kreshta gjelash valëviten mes dallgëve

Frynë edhe Deniku i tërbuar
Nga malet e mira shpërthejnë zërat
Thirrmat e zanave s'mejnë
Një stuhi prej resh të plumbta iu gjuajt tokës

Në stiva të çrregulluara i palosen drurët
Zëri trishtuar i mështeknës
Fshihej pas krakëllimave të korbave
Nata e verbër bredh zhveshur sokakëve

Në tërë lagjen nuk pushuan fshikullimat
E erërave të shurdhëta
Perëndimi me disa zogj të hekurt
I lëroi hullitë që me vite s'kishin çelur lule

NGA PULLAZET E MJEGULLTA

Si të babëzitur trokitëm
Nëpër portat e mbyllura të meteorëve
Gjëmat e detit duken si ariet e Chopin-it
Hëna si një shtambë deltine sodiste nga qielli

Nuk mbeti asnjë zog nëpër degët e nerenxës
Fluturuan edhe lejlekët e fundit
Atdheu i zhveshur qante në një valixhe
Nëpër stacione trenash mjaullin macet e egra

Mbrëmë i përjetuam përmbytjet e mjegullave
Disa zogj të çmendur
Fluturuan pa itinerar të mirëfilltë
Mbi kujtimet e plagosura të stinës dënes era

Nga pullazet e mjegullta
I dëgjuam zërat asnjanëse të drurëve
Qante e tërë lagja e dhunuar
Qanin pëllumbat postier për letrat e humbura

NUK PASHË ASGJË TJETËR

Nëpër radiot e qytetit
Asnjë lajmë për mëngjesin e ardhshëm
Thua se ka vdekur e nesërmja
Vetëm një muzikë e shthurur
Shkelë mbi trurin tim të lënduar

As nëpër kinema s'shohim itineraret
E së nesërmes
Vetëm pamjet apokaliptike të lakuriqësisë
Paraqiten nëpër ekrane
Duke na i drobitur ndjenjat

Gati i ndërrova të gjitha kanalet
Pamje dhunimesh
E prerje kokësh
Nuk pashë asgjë tjetër
Që mund ta kënaqte syrin tim të gështenjtë

E KJO TË MUNGON NË ÇDO KOHË

Ka çaste e çaste në jetë
Kur nga degët e pemëve
Zbret trishtimi
Dhe ulet mbi supet e lakuara

Ti nuk je në gjendje të bësh asgjë
Për të kundërshtuar
Duhet të kesh forcë mbinjerëzore
E kjo të mungon në çdo kohë

Kur të ngrysen mendimet e shthurura
Së bashku me vegimin tënd
I mbështetesh trungut të kalbur
Dhe bisedon me larvat e krimbave

Sot ose me ndonjë rast tjetër
Do ta kërkosh vetveten dhe duart e tua
Mes gjetheve të fishkura
Por do jesh i përhumbur si ëndrrat e tua

BARTIN FATIN E NJË KRYQI TË LËNGËT

Poqë se fshikullon era e tërbuar
Nëpër kujtesën e lumit
Ti del nga mëshikëza e harresës
Dhe shndërrohesh në heshtje
Ose në ndonjë përmendore të gurtë

Kurse duart e tua të lodhura
Bartin fatin e një kryqi të lëngët
Nga kambanorja fluturojnë
Zogjtë e kujtesës
Fluturojnë në drejtim të qytetit të varreve

Nëpër rrugët e pluhurosura
E të rrahura nga arabatë
Ngarkuar me dhembje
Kalojnë mbi bankinat e përgjumura
Lypsarët dhe hajdutët e pulave

Këndej pari kalojnë edhe apostuj
Njerëz që i përkasin një tjetër kaste
Të ndjekur nga njerëz të pashpirt
Për ta mbrojtur padronin
Nuk lënë mizë pa ndrydhur mbi këtë tokë

Prishtinë, 7 dhjetor 2014

SHARRI IDHNAK PËR HERË TË PARË

Si e çmendur trokite era
Nëpër të gjitha portat e drurëve
I zgjoi edhe zanat e përgjumura
Mali heshte
Heshtnin edhe degët nën peshën e dimrit

Nëpër shpirtra rrapesh
Të mbërthyera për gurtë e stralltë
U zgjuan vegimet
Një diell i ri
Kundronte nga lartësitë

Si pishtarët dardan mes kolonadave
Ndriçonin gjethet
Një qiell i kaltër hyri mes baladave
Dhe kurrë më
Nuk heshtën në tokën tonë
Daullet e kushtrimit

Flamujt e mermertë të vendlindjes
I grisën pikëllimet e shekujve
Nga zërat e sfinksave
Për herë të parë çilen portat e mbyllura
Dhe hynë në legjendë
Vegimet e valleve pagane

Gjatë tërë kohës
Gjethet recituan një poemë
Nuk ndalej as galdimi i rrënjëve
Sharri idhnak për herë të parë
Kalorësve të rrufeve
Ua lëshoi mëgojëzat e arta

VETËM SYRI I MAJTË I HËNËS

Në vetullat gajtan të liqenit
Dëgjohen mërmërimat e lehta të shkumës
Një ofshamë e thellë
E një gruaje të peshkatarit
Po i përpinë dallgët e trishtimit të bunacës

Mbrëmë nuk u kthye asnjë peshkatarë
Te moli i dhembjeve
Uji ndjente një zbrazëti
Të pashoqe në shpirt
Sa që ofshante si Drini i Bardhë

Fanarët nëpër brigjet e përhumbura
Herë kyçeshin
E herë shkyçeshin
Vetëm syri i majtë i hënës
Bënte nga pakë dritë udhëtarëve të vonuar

Edhe xixëllonjat e vetmuara
Po ashtu ndriçonin rrugën e qumështit
Në thellësinë e qenies së dallgëve
Trishtueshëm dëgjoheshin
Mjaullimat e maceve të egra

KËTO PAMJE APOKALIPTIKE

Mbrëmë i dëgjuam këlthitjet e natës
Më dukeshin ato zëra
Si krakëllima korbash të sëmurë
Një stuhi e dyshimtë
I shkuli nga rrënja pemët e fshatit

Gjëmuan edhe thikat e topitura
Gjaku në maja të shpatave
Çmendurisht dëneste
Dëneste edhe era si kërthi
Hëna e gjymtuar i shëronte plagët

Kaluan disa të huaj këndej pari
Por askush i gjallë
Nuk e ktheu kokën
Te faltoret e Kishës së Shën Premtes
Grumbuj duarsh dhe këmbësh të prera

Këto pamje apokaliptike
Mund të shihen
Vetëm në Ferrin e Dantes
Udha për në mëhallën time
Ishte më e gjatë se ajo e golgotës

Njerëz me shpirt të dërmuar
E kukëza të thyera
Gra pa shamia mbi kokë
Zogj të nakatosur nëpër çatitë e djegura
Ishin do pamje të trishtuara
Që i verbonin sytë e lëbyrtë të hënës

KUR QAJNË PEMËT

Nuk di vallë athua atë ditë
Isha ushtar
Ose dezertor i ndonjë beteje të humbur
Mbase nuk isha as ushtar
E as dezertor i penduar

Nuk jemi të gjithë trima
Ani që të gjithë e duam atdheun
Të veshur në kostume
Më të bukura kombëtare
E jo lakuriq pa asnjë këmishë në trup

Sa e sa herë
E pamë atdheun në dy gjunjë
Qante tok me rrapet e prerë
Qanin edhe shkurret e njoma
Çdo pemë qante me hidhërim
Në gjuhën e saj të drurët

LUTEJ VETËM LATINISHT

O Ati im i mirë më ndjeni
M'i falni gabimet nëse ekzistojnë
Ju lutem më tregoni
Në cilën gjuhë të lutem
Unë flasë vetëm shqip

Nuk pata kohë për gjuhët e huaja
Më janë dukur të largëta
Një stërgjysh i imi dikur moti
Lutej vetëm latinisht
O At në gjuhë të huaj
Lutej im gjysh
Në një gjuhë që asgjë s'kuptonte

Mbase edhe vdiq duke u lutur
Dikujt që s'dinte se kujt po i lutej
O Ati im i Mirë
Edhe një tjetër gjysh
Prej nëne lutej
Në një gjuhën të panjohur

E tani unë s’po i lutem
Asnjë Hyji
As gjuhën time Hyjnore
Nuk po e njehni Ju o At
Më tregoni
Kujt dhe si të lutem

SA PASKA ETJE KJO NATË E BRISHTË

Nëse mundem
Sonte dua t'i harroj degët e pemëve
Ato që lulëzonin
Dhe ato që sapo lëshonin rrënjë në tokë

Sa paska etje kjo natë e brishtë
Nga lastarët e kujtimeve
Asnjë pikë vese nuk pikon
E shirat si breshëri po i rrahin ullukët

Pranë muranave të qytetit
S'pushojnë as trishtimet e mjaullimave
As lehjet e tërbuara s'qetojnë
Një natë si kjo të mos përsëritet më

Nëse mundemi dhe kemi kohë
T'i ujisim pemët e thara
Lastarët do marrin frymë më lehtë
Do i ngjajnë peshqve të Lumëbardhit

I PËRNGJAJNË ARINJVE TË BARDHË

Këtu dimrat ngjajnë me njerëzit
Janë më se të ashpër
Fjollat e borës kafshojnë ditën
I ngrinë fluturimet e zogjve

Dimrat dardane kanë pamje kërcënuese
I përngjajnë arinjve të bardhë
Sa herë që acari kalon këndej pari
Kacafyten me lakuriqët e natës

Përherë në Ballkanin e trazuar
Dimrat kanë qenë si shpirtrat e kallkanëve
Deri vonë në pranverë
Nuk zbresin korbat nga çatitë e akullta

Këtu mes fushës së mëllenjave
Sa herë që është ngrirë dielli
Nga sqepat e zogjve shtegtarë
Kanë pikuar vetëm trishtimet dhe skamjet

Prishtinë, 8 dhjetor 2015

Dy zogj të verbër

Cikli i tretë

NË FILLIM DHE NË FUND TË QIELLIT

Nëpër dhembje plagësh
Shtruam dashurinë
Ditët ishin të gjata si rruga e golgotës
Në maje plepi
Vajtonte një kryq i vetmuar

Ecëm edhe disa vjet të pështira
Bëmë një jetë qençe
Askund asnjëherë nuk e pamë dritën
As në hyrje
E as në dalje të tuneli

Nëpër dhembje plagësh dhe shpresash
Sërish shtruam sofrën e dashurisë
Djemuria na doli maleve
Në fillim dhe në fund të qiellit
Pamë një dritë oreoli mbi kokën e atdheut

DIKU MALEVE PO SHKULEN LISAT

Ju lutem miqtë e mi
Mos mi prekni plagët sonte
Mos ju lutem
Nuk durohen këto dhembje koke

Në këtë rrugë të gjatë
Atdheut nuk i ka mbetur asnjë shpresë
Po bie sonte një shi i zi
Po bie nëpër rrugët e dhembjes
Dhe të golgotës

Askund nuk duket shpresa në këto çaste
I kemi harruar edhe kryqet paganë
Vetëm një shakullinë e çmendur
Po frynë nëpër brinjët e thyer të atdheut

Diku në mjedis të maleve po shkulen lisat
Po bien si nëpër balada edhe plisat
Gjëma e Drinit të Bardhë
Në këto çaste enda nuk qenka ndalur

AS ME LOTIN E TRISHTUAR TË ERËS

Mbrëmë i lëmë dyert e hapura
Le të hyj kush të do
Nëpër qiellin e portokalltë
Fluturojnë zogjtë e hekurt
Fluturojnë në heshtje mortore
Edhe kufomat e ndrydhura të hijeve

Ishte një kohë e zhgënjimeve
Njeriu nuk vlente as sa një lakër e verdhë
Nëpër fushat e ngrira të mëllenjave
Gati njëqind vjet
Nuk çeli asnjëherë pranvera
Sa me mallëngjim qante lumi i trishtuar

Shirat ishin bijtë e të çmendurve
Trokitnin nëpër xhama dhe mendjet tona
S'ndaleshin të trokiturat
As në shpirtra portash të mbyllura
Dyert e thyera të jetës
S'mund të rinovohen me asnjë lloj druri
As me lotin e trishtuar të erës

NJË NJERI I HUMBUR

Një njeri i humbur
Si varka e vetmuar noton nëpër dete
Dielli portokalltë
Fshihet pas fanarëve të kujtesës

Ti nuk erdhe mbrëmë
Nuk i pashë as turtujt e fëmijërisë
Ishte një natë e gjatë dhe e trishtë
Me disa zhgjëndrra të liga

Liqeni i kujtesës përmbytej në ëndrra
Asnjë sorkadhe s'fluturoi luadheve
Sterra i përngjante zogjve të verbër
Në syrin e tretë të natës
U fishkën zambakët e bardhë të Prizrenit

Mëngjesi ishte shumë larg
Shumë më larg
Se ëndrrat e mia të humbura
Ndoshta dita e gjykimit dergjej te trëndafilat
Mes gështenjave të egra dhunohej fjala

Një njeri i përhumbur
Mes dallgëve të shthurura të jetës
Me qindra vjet ëndërron molin e humbur
Ëndërron zogun e etjes në oazën e kujtesës

DO TË DOJA EDHE NJËHERË

Sonte kjo natë nuk paska fund
I mungon edhe fillimi
Ti dhe duart e tua
Jeni nata dhe drita ime që shkëlqen

Të kujtohen çastet kur atë ditë
Më mungonte frymëmarrja
Ishe ti që shkisje nëpër trupin tim
Kur përjetoja çastin e një ekstaze

Turtujt e egër të mëngjesit
Fluturonin nëpër gjumin tonë të uritur
E duart e tua prej mishi e gjaku
Aq bukur bisedonin me flokët e mia

Do të doja që edhe njëherë
Edhe njëqind herë
Mbase edhe me miliona herë
Ta ndjejë atë çast që rrallë kush e përjeton

FSHEHIN NË VETE ËNDRRAT E VITEVE

Si një apostull ecën shkallëve tërmal
Me veladon të bardhë
Mbulon ajrin e tendosur
Mizat e bezdisshme zukasin skutave
Megjithëse u përngjajnë njerëzve

Gjethet e vjeshtës veç shtrihen nëpër tokë
Një lloj shiu imcak
Troket mbi mermerët e varreve
Kjo portë e mbyllur
Hapet vetëm njëherë në mëngjes

Kurse herëve të tjera
Rri kyçur me një dry të çuditshëm
I cili ngjanë protezave të dhëmbëve artificial
Shkyçet vetëm atëherë kur zbresin engjëjt
Për t'i larë mëkatet e njerëzve të përhumbur

E shkallët që s'përfundojnë askund
Fshehin në vete ëndrrat e viteve
Dhe mëkatet e mëkatarëve
Që s'lahen as me lotin e Hyjit
E as me pendesën e orëve të fundit të jetës

KUR ÇMENDESHIN DIMRAT

Më kujtohet qoshja e shtëpisë
Ku ekzistonte një çarje
Aty babai im ndjesë pastë
E fshihte pushkën e vjetër
Të babagjyshit plak
E fshihte në atë çarje
Tok me një grusht fishekësh

Netëve të acarta
Kur çmendeshin dimrat
Me pjesët e një këmishe të vjetër
Me orë të tëra bisedonte
Dhe i tregonin njëri - tjetrit
Për ngjarjet që vetëm ata i dinin

Më kujtohet
O fare mirë më kujtohet
Qëndrimi i plakut tim
I cili s'lëvdohej asnjëherë
Sepse të luftosh për atdhe
S'do të thotë se duhet edhe të krekosesh
Si këndesi i sëmurë

DY ZOGJ TË VERBËR

Në amfiteatrin e pikëllimit
I pamë dy zogj të verbër
Mbi muranat e rrënuara
Për herë të fundit fluturuan
Kanjushat e verdha

Heshtja e mermertë
Disi e zhgënjyer përjeton
Metastazën e një vdekjeje të trishtuar
Mbi gurtë e murrmë të lashtësisë
Përhumben glasat e karbonizuara të korbave

Nëpër imagjinatë parakalojnë
Disa hije morbide
Parakalojnë si gladiatorët e vdekjes
Një vegim i verdhë te muranat
Përfundimisht përkulet deri në tokë

Dy zogj të verbër
Si dy hije sterre parakalojnë
Nëpër shpirtrat e gurëve të kalbur
Netët këtu kurrë s'janë të qeta
Mbase gjakun e njerëzve të pafajshëm
Akoma nuk e ka zënë gjumi

FUNDOSEJ NJË TREGIM

Mbrëmë hëna ma shkeli
Syrin e saj të tretë
Asnjë fanar nate
Nuk i ndriçonte mendimet e shthurura

Vetëm moli kundronte në heshtje
Dhe prite pa shpresë
Kthimin e peshkatarëve të humbur

Diku në barkun e uritur të detit
Fundosej një anije
Era i recitoi poemat e saja të lashta
Kepi i shpresës së mallkimit
Kishte mbetur pa pikë loti

Pak më vonë
Bunaca i lante duart në molin e pikëllimit
Gratë e peshkatarëve
I shqyen shamitë e bardha
Nata sterrë mbeti pa asnjë shpresë
U fundos mes dallgëve të dhembjes

TË VESHI NJË KËMISHË ME DY XHEPA

Edhe unë do shkruaj si Rreshpja
Për gjërat e mia personale
Po ashtu këmisha ime e arnuar
E pati fatin e kapelës
Së lënë diku në harresë

Më mbeti diku në gardhin e kujtimit
E kisha peng që nga fëmijëria
Këmisha ime e bukur
Këmisha e ime
Me qindra arna të arnuara

Dimrat ishin të acarta
Si mund të vishej këmisha
Me një mëngë të këputur
Kur kallkanët e egër i ngrinin
Edhe komçat e sedefta në belin e hënës

Si zogjtë që kthehen do vijnë stinët
Mbi çatinë e këmishës sime
Do fshihen në xhepin e majtë
O sa kisha dëshirë në fëmijëri
Të veshi një këmishë me dy xhepa

Prishtinë, 9 dhjetor 2014

E VETMJA SHPRESË QË U KA MBETUR

Mbi degët e lakuara të pemëve
Zogj të sëmurë
Grumbuj turtujsh fluturojnë pa qëllim
Qielli i errësuar dënes si kalama

Nëpër trotuare kalojnë njerëz të zhgënjyer
E vetmja shpresë që u ka mbetur
Është fluturimi në një tjetër degë
Por ku ta gjejnë atë copë druri pa dhembje

Në ikje e sipër ngjajnë turtujve të verbër
Nëpër drurët e lagjeve
Si një lloj amaneti i lënë pendlat
Mbase një ditë ëndërrojnë të kthehen

Fluturojnë në drejtim të ishujve
Pa asnjë adresë nëpër xhepat e shqyer
Do trokasin te portat e huaja
Ku s'janë mësuar të hapen për të tjerët

Pranë kajsishtave të mykura
Kanë mbetur disa turtuj të lënduar
Njerëzit bredhin të shpërfillur
Përpos skamjes asgjë nuk shohin para syve

URINË E VRASIM ME PIKËLLIM

Kohë pas kohe pa definuar
Mbi një dru prej bryme
Fluturuan disa lloje zogjsh
Shiu në këtë lagje bie vetë të mërkurave

Ditëve të tjera s'pushon ulërima e thatësirës
Aty këtu takoj fëmijë të ndrojtur
Me pantallona të arnuara
Presin shiun idhnak

Dimrat në këtë lagje
Ngjajnë me arinjtë e bardhë
Kur i zë uria e zezë i kafshojnë drurët
Për një kokërr të mykur misri çfarë nuk bëjnë

Këtu njerëzit përpos bujarisë s'kanë gjë tjetër
Të heshtur e krenarë ngjajnë me këto male
Kur u mungon buka e përditshmërisë
Pikëllimin e vrasin me uri

DO TË MË DUHET QË PAS BETEJËS SË FUNDIT

Në këto çaste vendimtare jam pak i lodhur
Lagja më sillet vërdallë në kokë
Edhe rrënjët e pemëve
Krahasohen me thellësinë e frymëmarrjes

Si të çmendura sonte po zbresin mjegullat
Një shi i zi po i verbon xhamat e kujtesës
As ullukët e vjetër s'po i zënë stërkalat
Këtu pareshtur ngjajnë vërshime përroskash

Ndoshta sonte do të vallëzojmë
Tangon e fundit të kësaj nate të tmerrshme
Kurse nesër herët në mëngjes
Na pret një rrugë e gjatë deri në atdhe

Do e marrë me vete edhe këtë këmishë
Të fishkur prej trishtimeve
Do të më duhet që pas betejës së fundit
Të vallëzojë vallen më të bukur të lirisë

NËSE NA PREMTON KOHA

Nesër që menatë do të dalim në shëtitje
Do marrim me vete pak kripë
Dhe bukën tonë të përditshme
Për të kafshuar trishtimin
Na duhen dhëmballë të hekurta

Nëse na premton koha
Domosdo duhet t'i peshkojmë çastet
Që na kanë mbetur peng nga e kaluara
Ka kohë që duart e rrudhosura të erës
Ngjajnë me kërpudhat e mykura

Mbase nuk patëm më shumë guxim
Ta ndryshojmë itinerarin e furtunës
Nëpër kontejnerët e qytetit
I mblodhëm kashelashat
Dhe filluam tu përngjajmë jashtëtokësorëve

PARA SE TË LËSHOHET AGULLIMA

Përtej dhomës sime
Nëpër ëndrrat e gjumit të natës
Ditë për ditë
Vijnë lejlekët e verdhë
Njëherë një kanjushe në sqepin e saj
Mbante një shami mbështjellë me erën

Nëpër këtë lagje me rrugë të kalldrëmta
Si zogjtë shtegtarë
Galopojnë davaritjet e reve
Nën rrapet e saja qindvjeçare
Akoma ndodhen faltoret pagane
Ku të varfrit e kësaj bote
I ndezin qirinjtë e shpresave

Vijnë edhe të huajt këtu
Për dhembje koke
Marrin nga një grusht dhe
Dhe pa humbur shumë kohë
Kalojnë në anën tjetër të lumit
Me një palë rruaze të sedefta
I mashtrojnë perënditë

2.

Në këtë lagje
Përherë ndodhin dhe kanë ndodhur
Gjëra të pabesueshme
Vijnë të gjymtit
Dhe flenë nën rrapin e moçëm
Dhe me padurim presin të nesërmen
Para se të lëshohet agullima
Mes gjetheve të fishkura
I harrojnë kukëzat me të cilat erdhën

NËPËR DEGËT E MËLLAGËS SË KUQE ÇELËN LULET

Hingëllonte mali
Nga të katër anët e fushave të djegura
Frynte një furtunë e zezë
Nëpër mjegullat e përgjumura
Kali i bardhë i Dukagjinit
Kalëronte si një hije hyjnore

Ishte një natë e ngarkuar me errësirë
Në vorbullën e ujërave të Drinit
Kali i bardhë
Tok me yjet e shpresës i kishte lëshuar grepat
Dhe peshkonte të nesërmen
Nëpër degët e mëllagës së kuqe
Çelën lulet më të bukura të stinës së harruar

Disa të rinj i kishin ndezur
Pishtarët dardan
Nga parzma e tokës mëmë
Si nga baladat e lashta
Mbinë hingëllimat e kalorësve
Mëllaga e bardhë dhe nerenxat
I çelën lulet si askund në ndonjë vend tjetër

Kurrë në jetë nuk kam parë
Qeshje më të bukur se sa në këtë kopsht
Qeshnin pemët e shkundura
S’ndaleshin
As buzëqeshjet e dimrit të acartë
Një pranverë e bukur
Pas njëqind viteve
Për herë të parë i hapi portat e mbyllura

NUK ËSHTË DUKUR NË TOKËN TONË

Ec nëpër këtë urë
Del përtej lëkurës tënde të zeshktë
Atje te lulishtet
Sivjet po çelin plepat gonxhe
Trëndafilash të përflakuar

Di çelin edhe vezët e ngjyrosura
Një stinë mahnitëse
Që asnjëherë më parë
Nuk është dukur në tokën tonë

Po lind një tjetër behar
Me disa lloje lulesh
Më të bukura
Që çelin nëpër shpirtra njerëzish
Dhe kopshtesh me aromë dashurie

Ec përtej asaj ure e cila i lidh
Që të dy brigjet e Lumëbardhit
Andej gurgullimës së ujit
Krenaria e kalasë së vjetër
Kurse këndej brigjeve Kisha e Shën Premtes

Prishtinë, 10 dhjetor 2014

SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990*, nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. **“Bajraktarët e vatanit”,** poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 **“ Ky def prej hëne”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012

78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88**.”Sytë e gurtë të erës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89**.”Kur dehen perënditë”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. **“Fjetëm njëqind shekuj”** Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91**.”Krakëllimat e natës”,**Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. **“Ndjekësit e enigmave”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014

93. **“Atdheu i paçmuar**”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94**.”Psalm i harruar ”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”**Për që po bie moj kambanë**”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
96. **“Mbi flokët e ullukëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. **“Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e** Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98**. “Loti i gotës së dehur”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99**. ” Stina asnjanëse”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. **“Dëneste bashkë me erën”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. **“Druri i pikëlluar**”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. **“ Një grusht dashuri”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. **“Lëreni zërin tim”** , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. **“Shi në qytetin tim”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
105. **. “Si trenat e verbër ” ,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. **“Zjarri i malli tim ”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
107 **. “Kur teshtinë era** ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014

108. "Mbi shpirtin e erës pagane " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
109. "Nëpër gjymtyrët e mjegullave " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2014
110"**Ajo nuk erdhi sonte"** Poezi, Shtëpia Botuese TREND- Prishtinë, 2015
111**."Një hënë e zhveshur",**Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
112. "**Nëpër plasaritjet e mureve",**Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
113**."Mes telave gjembor ",**Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
114. **"Të vizatosh një zog në mur",**Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
115**." Nuk flenë as kuajt e dehur"** Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
116**"Fluturojnë zogjtë e verbër "** Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
117. **"Një shi prej bryme" ,** Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
118**. "Në prehrin e pemëve"** Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
119**. "Zëri i largët i shiut " ,** Poezi Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
120**. "Yjet e ngrira të kujtesës " ,** Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
121**. " Thirrmat e hijeve" ,** Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
122**. "Dritaret e verbëta " ,** Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015

123 **. "Përtej portave të mbyllura" ,** Poezi, Shtëpia Botuese TREND – Prishtinë, 2015
124. "Malli i etjes " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2015
125. "Kur qajnë pemët " , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"- Kastriot, 2015

PËRMBAJTJA

Këtu edhe netët lehin
Cikli i parë 9

Nën tingujt e një muzike pagane 11
Nga zëri bariton i muranave 12
Po i gërryen muranat e kujtesës 13
Një dru i lodhur 14
Të nesërmen kur zgjohen plepat 15
Te sukat e blerta 16
Përtej mendimeve tona 17
Kuvendojnë me gjethet e rëna 18
Një çerdhe trishtili 19
Mes rrënjëve fshihen të reshurat 20
Sa shumë dallojnë të uriturit 21
Po të ishte bota 22
Asnjë shteg mali 23
Këtu edhe netët lehin 24
Kam një hall e kam një mall 25
Përngjajnë me njerëzit sy uritur 26
Sërish për zogjtë 27
Nga një mallkim i keq 28
Drurët ngjanin njerëzve pa duar 29
Kur na i grisnin flamujt 30
Mëngjesi i dyshimtë 32
Qanin si kërthinjtë e braktisur 33
Kjo pranverë e varfër 34
Thirrmat apokaliptike 35
U takova me rrugët e përgjumura 36

Kur qajnë pemët
cikli i dytë 37

Me një vdekje të trishtuar 39
Të gjitha udhët 40
I hapim sytë në drejtim të drurëve 41
Veshur me sedef guacash 43
Me zor lisat marrin frymë 44
Mbi një gur stralli 45
Tek portat e jashtme 46
Thonë se qielli ishte i ngjyrosur 47
Nuk prajnë as mjaullimat 48
Cili djall kaq hajnisht hyri 49
Ata që flenë 50
Më duket se ishte koha e luleve 51
Më në fund kuptojmë 52
Të t'i përkujtoj gjëmat e ditëve 53
Ku na mbetën fjalët 54
Perëndimi me disa zogj të hekurt 55
Nga pullazet e mjegullta 56
Nuk pash asgjë tjetër 57
E kjo të mungon në çdo kohë 58
Bartin fatin e një kryqi të lëngët 59
Sharri idhnak për herë të parë 60
Vetëm syri i majtë i hënës 62
Këto pamje apokaliptike 63
Kur qajnë pemët 65
Lutej vetëm latinisht 66
Sa paska etje kjo natë e brishtë 68
I përngjajnë arinjve të bardhë 69

Dy zogj të verbër
cikli i tretë 71

Në fillim dhe në fund të qiellit 73
Diku maleve po shkulen lisat 74
As me lotin e trishtuar të erës 75
Një njeri i humbur 76
Do të doja edhe njëherë 77
Fshehin në vete ëndrrat e viteve 78
Kur çmendeshin dimrat 79
Dy zogj të verbër 80
Fundosej në tregim 81
Të veshi një këmishë me dy xhepa 82
E vetmja shpresë që u ka mbetur 83
Urinë e vrasim me pikëllim 84
Do të më duhet që pas betejës së fundit 85
Nëse më premton koha 86
Para se të lëshohet agullima 87
2. 88
Nëpër degët e mëllagës së kuqe çelin lulet 89
Nuk është dukur në tokën tonë 91

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Kur qajnë pemët / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : “Trend”, 2016. – 105 f. ; 21 cm. -

Shënime për autorin : f. 92-100

ISBN 978-9951-694-51-3